



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1474 Prot.

Tiranë, më datë 08.10 .2021

**VENDIM**  
**Nr. 598, datë 08.10.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.10.2021:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit të zbatimit “Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit”, me aplikues “SPHAERA” sh.p.k, projektues restaurator z. Genci Samimi dhe zhvillues Bashkia Pogradec;
2. Në zbatim të Nenit 10 dhe Nenit 11 të Vendimit të Ministrave Nr. 554, datë 18.06.2015 “Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj”:
  - Punimet të zbatohen nga subjekte të licencuara në zbatim për ndërhyrje në pasuri kulturore për këtë kategori projektesh;
  - Punimet e restaurimit dhe rikonstruksionit të mbikëqyren dhe kolaudohen nga IKTK, DRTK Korçë ose subjekte të licencuara në mbikëqyrje kolaudim për ndërhyrje në pasuri kulturore për këtë kategori projektesh;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

